



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 1548 prot.

Shkodër, më 23.04. 2026

V E N D I M

Nr. 127, datë 23 . 04 .2026

**"PËR KRYERJEN E NJË NDRYSHIMI NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI" PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa ç; Statutit të USH-së, Neni 17, pika 6, germa d; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar); Ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"; i ndryshuar; Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë"; referuar shkresës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit nr.328 prot, datë 20.04.2026, regjistruar në Rektorat me nr.1487 prot, datë 20.04.2026, e cila përcjell relacionin e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporte mbi arsyet e kërkesës së parashtruar; duke qënë se kryerja e ndryshimit/saktësimit nuk paraqet ndikime financiare, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026,

V E N D O S I:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit kryerjen e një ndryshimi në Vendimin e BA nr.76, datë 24.02.2026 "Për miratimin e strukturës organizative të USH-së për vitin 2026", për Departamentin e Edukimit Fizik dhe Sporte, pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, nëpërmjet saktësimit të emërimit të pozicionit nga "Specialist/Laborant", në "Specialist".
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tahir Gjuraç